



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-110/01-0031372/25
No. _____
Data 01.08.2025
Data _____



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ**

Skenderaj, 2025

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 2, paragrafin 3, nenin 8, nenin 13, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 20 dhe 61 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 31.07.2025 miraton këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba të Komunës së Skenderajt.

Neni 2

2.1 Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë, i cili formulohet si në vijim:

2.2 Nga taksa për automjete lirohen: **familjet e ngushta të dëshmorëve, familjet e ngushta të viktimave civile, familjet e ngushta të të zhdukurve (pagjeturve) të UÇK-së, familjet e ngushta të të zhdukurve (pagjeturve) civilë, invalidët e luftës (personalisht), veteranët e luftës (personalisht) dhe personat me aftësi të kufizuara (personalisht).**

2.3 Në familjet e ngushta përfshihen: **Prindërit, bashkëshorti ose bashkëshortja, dhe fëmijët.**

2.4 Lirimi bëhet në bazë të prezantimit të dëshmisë (dokumenti bëhet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës) dhe në këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0), duke i'a bashkëngjitur dëshminë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Kryesia e Kuvendit

Adina Spahiu





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-110/05-0029544/25

Data 22.07.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _____ 2025, të miratojë këtë:

PROPOZIM

- I. Për miratimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Nr.01-110/01-0025382/22, dt. 06.06.2022.
- II. Draft Rregullorja cekur në pikën I të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/01-0026288/25, të datës 04.07.2025.
- III. Drafti i cekur në pikën I ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.
- IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur: Drafti i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

Kryetari i Komunës

Fadil Nura





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ**

Skenderaj, 2025

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja e). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 2, paragrafin 3, nenin 8, nenin 13, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 20 dhe 61 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: _____ miraton këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba të Komunës së Skenderajt.

Neni 2

2.1 Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë, i cili formulohet si në vijim:

2.2 Nga taksa për automjete lirohen **familjet e dëshmorëve (familja e ngushtë), familjet e viktimave civile (familja e ngushtë),** invalidët e luftës (**personalisht**), veteranët e luftës (**personalisht**) dhe personat me aftësi të kufizuara (**personalisht**).

2.3 Në familjet e ngushta përfshihen: **Prindërit, bashkëshorti ose bashkëshortja, dhe fëmijët.**

2.4 Lirimi bëhet në bazë të prezantimit të dëshmisë (dokumenti bëhet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës) dhe në këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0), duke i'a bashkëngjitur dëshminë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Kryesuesja e Kuvendit

Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIQUE DU KOSOVO
UDHËZIM NË MUNICIPA/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr
No 02-020/07-00262 88/25
Data
Data 04.07.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

- I. **Formohet** grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, në këtë përbërje:
 1. **Besnik Smakaj**, kryesues
 2. **Amir Lushtaku**, anëtar
 3. **Ilmi Kabashi**, anëtar
 4. **Antigona Maliqi**, anëtare
 5. **Dafina Shala**, anëtare
- II. **Detyrë** e grupit punues nga pika I e këtij vendimi, është zbatimi i procedurave për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, konform legjislacionit në fuqi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuesit të grupit punues
- Anëtarëve të grupit punues


Kryetari i Komunës

Fadil Nura





Republika e Kosovës
Skenderaj Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Opstina Skenderaj
Municipality of Assembly

Bazuar në ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr. 110-385, neneve 28 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë:

Njoftim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 04.07.2025 deri me datën 21.07.2025 ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 14.07.2025, në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën 21.07.2025 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: besnik.smakaj@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.

Për më shumë detaje plotësim-ndryshimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22 mund të vizitoni vegëzën e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Rregullore-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-per-taksa-tarifa-ngarkesa-dhe-gjoba-1.pdf>

Amir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun

